



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
Studime Amerikane II

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore: 20 orë leksion; 20 orë seminar

**Viti akademik / Semestri kur zhvillohet:** Viti III, semestri II

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor – Studime Britanike dhe Amerikane

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshëm lëndor:* Të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme kulturore për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke ndihmuar në ndërtimin e një kuptimi të thellë për shoqërinë amerikane. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të analizuar në mënyrë kritike vlerat, parimet dhe institucionet që përbëjnë bazën e kulturës amerikane. Të nxisë ndërgjegjësimin ndërkulturor dhe respektin ndaj diversitetit, përmes studimit të fenomeneve kulturore amerikane në krahasim me kulturën vendase ose të tjera kultura.

*Objektivat specifikë lëndorë:*

1. Të njohin studentët me vlerat themelore amerikane, si liria individuale, punëtoria, barazia e mundësive, konkurrenca, suksesi personal etj.
2. Të kuptojnë si janë formuar dhe zhvilluar këto vlera dhe parime në kontekstin historik dhe social të SHBA-së.
3. Të analizojnë mënyrën se si këto vlera pasqyrohen në aspekte të jetës së përditshme.

*Rezultatet e pritshme:* Në përfundim të kësaj lënde (modulet I dhe II), studentët do të jenë në gjendje të:

1. *identifikojnë* elemente të kulturës amerikane në tekste, lajme, ngjarje, postime në media sociale;
2. *diskutojnë* rreth temave aktuale amerikane në dritën e vlerave amerikane tradicionale;
3. *analizojnë* çështje shoqërore në kulturën amerikane dhe se si këto çështje sfidojnë vlerat amerikane tradicionale;
4. *shkruajnë* dhe *prezantojnë* rreth temave të kulturës amerikane bazuar në të kuptuarit e vlerave dhe parimeve që përbëjnë themelet e kësaj kulture.